REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit, Nr. 317
Tiranë/Albania

t: +355 (4) 2362 989/2347 298
f: +355 (4) 2362 984
e: info@asd.gov.al
w: www.asd.gov.al

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 24, datë 03.08.2021

"Për miratimin e planit strategjik për auditimin e brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitet 2021 – 2024, si dhe të planit vjetor për auditimin e brendshëm për vitin 2021"

Në mbështetje të nenit 52, pika 1, shkronja "j", të nenit 63, pika 2 të Ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "*Për sigurimin e depozitave*", të ndryshuar, të nenit 18, pika 3 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr.24, datë 31.10.2018, të nenit 11, pika 1 dhe pika 4, shkronja "a" të Rregullores "Për Kartën e Auditimit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave", të miratuar me Vendim Qarkullues të Këshillit Drejtues nr. 16, datë 30.04.2020, të nenit 18, pika 2 të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 "Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave", si dhe me propozim të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Deloitte Audit Albania" sh.p.k dhe "Deloitte Albania" sh.p.k, Këshilli Drejtues,

---

V E N D O S I:

1. Miratimin e planit strategjik për auditimin e brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitet 2021 – 2024, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Miratimin e planit vjetor për auditimin e brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2021, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet bashkimi i operatorëve ekonomikë "Deloitte Audit Albania" sh.p.k dhe "Deloitte Albania" sh.p.k, në cilësinë e audituesit të brendshëm, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi — **Sekretar**

Donald Duraj — **Kryetar**